

**Njoftim për përqendrim që i referohet fitimit të kontrollit nga ALFI Renuabls, menaxhim i fondeve të investimeve alternative, doo., Slloveni mbi SUPERNOVA ÇAZMA d.o.o., Republika e Kroacisë dhe SN DUBICA d.o.o., Republika e Kroacisë, si dhe indirekte mbi shoqëritë Çazma Energia d.o.o., Republika e Kroacisë dhe Dubica Energia d.o.o., Republika e Kroacisë**

**(lënda nr. 08-103 /2024)**

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 22.07. 2024, e në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin që i referohet fitimit të kontrollit të pavarur nga ALFI Renuabls, menaxhim i fondeve të investimeve alternative, d.o.o. me seli të regjistruar në adresën Verovshkova rruga 55A, 1000 Lubjanë, Slloveni mbi shoqëritë SUPERNOVA ÇAZMA d.o.o. me seli të regjistruar në adresën Avenue Veçeslava Holjevca 62, Zagreb, Republika e Kroacisë dhe SN DUBICA d.o.o. me seli të regjistruar në adresën Avenue Veçeslava Holjevca 62, Zagreb, Republika e Kroacisë, me seli të regjistruar në adresën Avenue Veçeslava Holjevca 62 si dhe kontroll indirekt mbi shoqëritë Çazma energia d.o.o. me seli të regjistruar në adresën Novaçiqja Milana 7, Qyteti Çazma, Republika e Kroacisë dhe Dubica energia d.o.o. me seli të regjistruar në adresën Novaçiqja Milana 7, Qyteti Çazma, Republika e Kroacisë.

**-ALFI Renuabls, menaxhimi i fondeve të investimeve alternative, d.o.o.** është një shoqëri sllovene për menaxhimin e fondeve të investimeve alternative, e themeluar në fund të vitit 2020, me një aktivitet kryesor të regjistruar – menaxhimin e fondeve. ALFI Renuabls menaxhon një fond investimi të specializuar për burimet e energjisë së gjelbër ALFI, Fondi Special i Investimeve, me seli të regjistruar në adresën Verovshkova rruga 55A, 1000 Lubjanë, Republika e Sllovenisë („ALFI Grin Enerxhi Fand“ i cili kryen veprimtarinë e investimit të fondeve, të mbledhura nga investitorë të ndryshëm sipas politikës së saj të investimeve, në termocentralet e erës dhe fotovoltaike që prodhojnë energji elektrike përmes transformimit të erës dhe dritës së diellit si burime natyrore të rinovueshme, mundësisht në fazën e ndërtimit ose në fazën e mëvonshme të zhvillimit.

Grupi Alfi, i parë në një kuptim më të gjerë (i cili përfshin ALFI Renuabls dhe ALFI Grin Enerxhi Fand), ka regjistruar praninë lokale përmes një shoqërie të varur indirekt dhe fiton të ardhura në Maqedoninë e Veriut përmes shitjeve me shumicë të lodrave, pajisjeve cilësore për fëmijë, aksesorëve për fëmijë dhe produkte tekstili për fëmijë.

**-SUPERNOVA ÇAZMA d.o.o.** është një shoqëri për qëllime të veçanta, e themeluar më 3 tetor 2023 në Republikën e Kroacisë, me aktivitet prioritar të regjistruar - prodhimi i energjisë elektrike (shifra e aktivitetit: 35.11).

Shoqëria Çazma Energia është themeluar më 24 mars 2023 dhe ka zhvilluar projektin për termocentralin fotovoltaiik „Çazma“ në qarkun Bjelovar-Bilogora, Republika e Kroacisë, me një kapacitet të parashikuar lidhjeje prej 90 MW. Çazma energia zotëron disa prona, leje dhe të drejta për zhvillimin dhe ndërtimin e një termocentrali fotovoltaiik „Çazma“.

Supernova Çazma (përfshirë shoqërinë Çazma energia) nuk ka shoqëri të regjistruara të varura dhe as realizon të ardhura në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

-**SN DUBICA d.o.o.** është një shoqëri për qëllime të veçanta e themeluar më 3 tetor 2023 në Republikën e Kroacisë, me aktivitet prioritar të regjistruar - prodhimi i energjisë elektrike (shifra e aktivitetit: 35.11).

Shoqëria SN DUBICA d.o.o. u themelua më 15 qershor 2023 dhe ka zhvilluar projektin për termocentralin fotovoltaik „Dubica” në qarkun Sisak-Moslava, Republika e Kroacisë, me një kapacitet të parashikuar lidhjeje prej 90 MW. Dubica energjia zotëron disa prona, leje dhe të drejta për zhvillimin dhe ndërtimin e një termocentrali fotovoltaik „Dubica”.

SN DUBICA d.o.o. (përfshirë shoqëritë Dubica Energia) nuk ka shoqëri të regjistruara të varura dhe as nuk gjeneron të ardhura në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Tregu përkatës i mallrave në Maqedoninë e Veriut duhet të përkufizohet si treg për prodhimin dhe shitjen e energjisë elektrike me shumicë.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: [kzk@kzk.gov.mk](mailto:kzk@kzk.gov.mk) dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

24.07.2024

Shkup